



A.nr.513/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.513/2026, të datës 07.05.2026, të parashtruar nga ankuesi L.M, nga Graçanica, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.513/2026, e datës 07.05.2026 e parashtruar nga ankuesi L.M.

A r s y e t i m

Ankuesi L.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 07.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit, në kërkesën e ankuesit të datës 16.04.2026.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 2210/2026 të datës 07.05.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për pagesën e pushimit vjetor të pashfrytëzuar më datë 16.04.2026 nga ankuesi; Komunikime me telefon; Kontratë Punë me Nr. 246/2025 e datës 03.07.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.05.2026.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, **është e parakohshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Kontratës së Punës për periudhën të caktuar kohore me Nr. 246/2025 të datës 03.07.2025, është punësuar në pozitën *Zyrtar Ligjor* në Departamentin për Zyre për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financa të Subjekteve Politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Më datë 16.04.2026, ka parashtruar kërkesë te Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për pagesën e pushimit vjetor të pashfrytëzuar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ngrit pretendimet që gjatë periudhës së angazhimit kanë qenë zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për shkak të fluksit të shtuar të punës ka qenë e pamundur të shfrytëzohet pushimit vjetor, duke shtuar tutje se institucioni nuk e ka shqyrtuar kërkesën e datës 16.04.2026. Kërkon që detyrohet KQZ të nxjerr akt administrativ për kërkesën e tij, të aprovohet kompensimi financiar për pushimin vjetor të pashfrytëzuar dhe të konstatoj shkeljen e të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Në kuptim të pranushmërsisë së ankesës, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, ndërsa sipas nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: *“2 Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj...”*, si dhe nenin 127 ku është përcaktuar se: *“1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”*. Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është ushtruar para afatit ligjor për heshtje administrative, për faktin se ankuesi më datë 16.04.2026, ka parashtruar kërkesë organit të punësimit, dhe për rrjedhojë organi i punësimit ka pasur afat ligjor për shqyrtimin e kërkesës së palës 45 ditë sipas dispozitave ligjore të cekura më lartë, kështu që mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, vlerëson se ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa kaluar afati për shqyrtim të kërkesës nga ana e organit publik në këtë rast organit të punësimit.

Në këtë kontekst, meqë ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar para kalimit të afatit ligjor për të shqyrtuar kërkesën e datës 16.04.2026, në kuptim të nenit 98 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e palës ankuses është parashtruar në kundërshtim me afatet e parashikuara me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërlidhur me nenin 98 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji, kështu që bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin se ankesa e ankuesit e datës 07.05.2025 është parashtruar në kundërshtim me afatin ligjor sipas nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë konsiderohet e pranueshme në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të këtij ligji.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.513/2026, datë 17/06/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit L.M;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të SKQZ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.